

PROJEKTET NË ZBATIM THIRRJA E 3-TË

GRANT-MARRËSIT ORGANIZATA JO FITIM-PRURËSE

Nr	Organizata	Projekti	Përshkrim i Shkurtër	Kohëzgjatja (muaj)	Zona e Zbatimit
1	OPEN DOORS	KonceSCAN	Kontratat koncesionare janë një aktivitet i ri për pushtetin vendor, prandaj lind nevoja të monitorohet si një proces me risk të lartë për t'u prekur nga abuzimi dhe korrupsioni, por edhe për transparencë ndaj komunitetit që afektohet drejtpërdrejt. Projekti synon të monitorojë investimet dhe shërbimet publike të ofruara nga pushteti vendor në Fier dhe Divjakë nga zbatimi i kontratave koncesionare/ PPP përmes a) analizës së këtyre kontratave, b) matjes së perceptimit publik për to dhe c) të advokojë për interesat e komunitetit mbi dobishmërinë dhe efektivitetin e tyre.	12	Fier, Divjakë
2	Qendra Aleanca Gjinore per Zhvillim (Gender Alliance of Development Center)	Monitorimi i funksioneve të deleguara të Bashkive në lidhje me Qendrat e Shërbimit Shëndetësor Parësor	"Mirëmbajtja dhe investimet në Qendrat e Kujdesit Shëndetësor Parësor (QSHKP-) me ligjin e ri ""Për Vetqeverisjen Vendore"" janë funksione të deleguara bashkive, por qeveria qendrore nuk ka deleguar fonde dhe tashmë këto qendra janë lënë në mëshirë të fatit. Qëllimi kryesor i këtij projekti është të përfshijë dhe fuqizojë qytetarët në monitorimin e qendrave shëndetësore të kujdesit parësor në bashkitë e tyre, duke advokuar në pushtetin vendor dhe në qeverinë qendrore për të ndryshuar situatën në to. Më konkretisht synohet që: a) të krijohet një metodologji e replikueshme për t'u përdorur në vazhdimësi nga aktorë të ndryshëm për monitorimin e funksioneve të deleguara të bashkive; b) të fuqizohen 36 qytetarë nga bashkitë e targetuara që të monitorojnë QSHKP-ve në bashkitë e tyre; c) të raportohet pranë bashkive për gjendjen e QSHKP-v dhe të lobohet që në buxhetin e 2018 dhe më tej të ketë zë të veçantë për përmirësimet të QSHKP-vë; d) Të lobohet me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Shëndetësisë që bashkive t'u alokohen fonde në lidhje me qendrat shëndetësore.	12	Pogradec, Mirditë, Gramsh, Urë Vajguore, Kuçovë
3	Vizion i Gjelber	Vlora në lëvizje	Qytetarët vlonjatë dhe turistët janë duke vuajtur prej dy vjetësh në disa mënyra abuzimin e koncesionit të parkimeve nga firma TIS PARK. Projekti synon adresimin tek vendimarrësit të shqetësimit të qytetarëve të çertifikuar nga juristët nëpërmjet informimit, lobimit, advokimit, peticionit dhe protestës për të patur një funksionim më efikas të koncesionit në interes të komunitetit deri në rishikimin e kontratës koncesionare. Më specifikisht do të punohet për të ndaluar veprimtarinë e paligjshme të koncesionit të parkimeve ndaj qytetarëve.	5	Vlorë

PROJEKTET NË ZBATIM THIRRJA E 3-TË

GRANT-MARRËSIT ORGANIZATA JO FITIM-PRURËSE

Nr	Organizata	Projekti	Përshkrim i Shkurtër	Kohëzgjatja (muaj)	Zona e Zbatimit
4	Qendra "Blegtoria dhe Zhvillimi Rural" (BZHR)	Bujqësia - Detyrim dhe përgjegjësi për pushtetin vendor.	Funksionet e reja që i janë dhënë bashkive në bazë të ligjit të ri Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" për bujqesine nuk janë transferuar tërësisht nga Ministria e Linjës dhe nuk ofrojnë informacion cilësor dhe që arrin në kohën e duhur tek fermerët. Në bashkitë e targetuara ka rreth 31200 ferma, që përbëjnë zonën bujqësore më të rëndësishme të Shqipërisë. Projekti synon të përmirësojë qeverisjen vendore dhe shërbimet bujqësore ndaj fermerëve nëpërmjet a) monitorimit dhe nxitjes së kalimit të funksioneve të reja që i janë dhënë bashkive në bazë të ligjit të ri Nr. 139/2015 për bujqësinë dhe b) të ndërgjegjësojë Shoqatat e Fermerëve për rëndësinë e informimit dhe transparencës për vendimet e mara për bujqësinë, shërbimet dhe këshillimet bujqësore nga bashkitë dhe Njësitë Administrative.	12	Lushnjë, Kuçovë, Belsh.
5	Qendra Rinore e Vlorës	Vlerësimi i Komunitetit për Qeverisjen në Bashkinë Selenicë	Të ndodhur para ndryshimeve thelbësore si rezultat i reformës administrative territoriale, qytetarët e Bashkisë Selenicë përfaqësojnë një komunitet të mënjanuar nga vendimmarrja lokale dhe kontributi i tyre në vendim-marrje është i vogël. Qendra Rinore e Vlorës synon realizimin e metodologjisë së Vlerësimit të Komunitetit për Qeverisjen në Bashkinë Selenicë. V.K.Q. i njohur edhe si "zëri i komunitetit", është një mekanizëm që do të përdorë komunitetin në të gjashtë njësitë administrative të Selenicës, si njësi analize për të nxitur llogaridhënien, transparencën dhe angazhimin qytetar.	9	Selenicë
6	Instituti Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve (INSIZ)	Nxitje dhe jetesim i mekanizmave për pjesëmarrjen qytetare në procesin e advokimit, lobimit dhe hartimit të bazës ligjore për organizimin dhe zhvillimin e referendumeve lokale.	Zhvillimi i mekanizmave ligjor të nevojshme për të mbështetur dhe realizuar iniciativat komunitare për referendum lokal. Zhvillimi i kapaciteteve komunitare për të ndërmarr dhe realizuar iniciativë për referendume vendore. Realizimi i sinergjive në bashkëpunimin, komunitet & organe të qeverisjes vendore, për formimin e kulturës referendare dhe rritjes së pjesëmarrjes direkte të qytetarëve në vendimmarrje dhe për zgjidhjen e problemeve të qeverisjes vendore. Zhvillimi i kapacitetit të nevojshme në komunitetet qytetare për të lobuar dhe për të mundur realizimin e të drejtës për referendum lokal. Hartimi i draft propozimeve për ndryshime ligjore të nevojshme për realizimin praktik të të drejtës për referendum lokal. Ndërtimi i rrugëve efektive të komunikimit midis të zgjedhurve vendor dhe komuniteteve qytetare në zonat urbane e rurale, të cilat do të bëjnë të mundur nxitjen, mbështetjen, organizimin dhe realizimin e referendumeve vendore.	9	Durrës, Elbasan

PROJEKTET NË ZBATIM THIRRJA E 3-TË

GRANT-MARRËSIT ORGANIZATA JO FITIM-PRURËSE

Nr	Organizata	Projekti	Përshkrim i Shkurtër	Kohëzgjatja (muaj)	Zona e Zbatimit
7	Qendra për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe të Integruar	Përmirësimi i Shërbimit të Kullimit në Bashkinë Shkodër	"Funksionet e bujqësisë dhe të zhvillimit rural, ku bëjnë pjesë shërbimë të tilla si ujitja dhe kullimi, sipas Nenit 27 të Ligjit 139/2015 për Vetëqeverisjen Vendore janë funksionë të veta të bashkisë. Por si funksione të transferuara këtë vit dhe të financuara me transfertë specifike ato ushtrohen si funksione të deleguara. Mbi 40.000 familje të njësive administrative të Bashkisë Shkodër vuajnë përmbytjen sistematike të rreth 4.000 dynymëve tokë bujqësore dhe Ministria e Bujqësisë nuk ka kryer investime të nevojshme në këtë sistem. Projekti synon përmirësimin e shërbimeve publike në nivel vendor në përputhje me ligjin dhe standartet e përcaktuara. Objektivat specifike kanë të bëjnë a) me përmirësimin e shërbimit të kullimit në bashki në bashkëveprim dhe bashkërendim me komunitetin; b) ngritjen dhe konsolidimin e kapaciteteve vendore në lidhje me metodat e planifikimit, manaxhimit dhe monitorimit të shërbimit; c) rritjen e ndërgjegjësimit dhe rolit qytetar në proceset konsultuese, advokuese, vendimmarrëse dhe monitoruese.	12	Shkodër (Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Velipojë, Gur i Zi).
8	EuroPartners Development	Decentralizimi - Delegimi i funksioneve dhe sfidat e zbatimit "Funksioni i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi",	Funksionet e përbashkëta kanë qenë një nga fushat ku decentralizimi ka pasur progres, por jo me hapat e duhura. Për forcimin e rolit të NJQV dhe rritjen e efektivitetit në kryerjen e shërbimeve publike, si dhe në zbatim të Ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", u miratuan disa vendime mbi transferimin e disa funksioneve nga ML, bashkive. Ndër këto funksione është edhe "Funksioni i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi", funksion i cili me ndryshimet e reja ligjore të bëra në Ligjin për Përbashkimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin" i kalon plotësisht bashkive. Qëllimi kryesor i këtij projekti është evidentimi i ecurisë së procesit të delegimit të funksionit të shërbimeve për mbrojtjen nga zjarri dhe me specifikisht të delegimit të këtij funksioni pranë pushtetit vendor në Bashkitë Berat, Lushnje, Kukës, Malësi e Madhe, Vau i Dejës dhe Pogradec.	12	Malësi e Madhe, Vau i Dejës, Lushnjë, Berat, Pogradec dhe Kukës
9	Qendra Media dhe Çështjet Shoqërore	Të lëvizim për sportin dhe kulturën në periferi të Tiranës	Sporti dhe kultura, mund të cilësohen më shumë se luks për banorët e zonave periferike të Tiranës. Në këto zona në shumicën e rasteve mungojnë terrenet sportive, por edhe aty ku ato janë nuk shfrytëzohen nga të rinjtë. Qëllimet e këtij projekti janë: a. Angazhimi direkt i të rinjve dhe lobimi në pushtetin vendor për të zhvilluar me shume jetën kulturore dhe sportive në periferi të Tiranës. b. Lobim në bashkinë e Tiranës (pjesë e të cilës janë tashmë këto zona), për më shumë investime në infrastrukturën sportive dhe jetën kulturore në periferi.. Të rinjtë do të krijojnë një lidhje me organet e qeverisjes vendore që kanë për detyrë t'iu garantojnë një jetë shoqërore më cilësore. Publikimi në media i gjendjes në këto zona.	12	Njësitë administrative në periferi të Tiranës: Baldushk; Farkë; Kashar ; Ndroq ; Pezë ; Vaqarr ; Zall-Bastar ; Krrabë ; Yzberisht ; Shën Gjergj ; Berzhitë ; Petrelë ; Zall -Herr

PROJEKTET NË ZBATIM THIRRJA E 3-TË

GRANT-MARRËSIT ORGANIZATA JO FITIM-PRURËSE

Nr	Organizata	Projekti	Përshkrim i Shkurtër	Kohëzgjatja (muaj)	Zona e Zbatimit
10	Shoqata Ryder Albania	Monitorimi i shërbimit paliativ për pacientet me kancer dhe kronike në Durrës.	Në Durrës, numri i të sëmurëve me kancer dhe sëmurëve kronik në nevojë të kujdesit paliativ është në rritje. Pacientët kanë akses të kufizuar dhe cilësi të vakët të shërbimit; ligji i kujdesit paliativ i miratuar në vitin 2014 dhe standardet e shërbimit të miratuara në 2013 nuk njihen dhe respektohen, duke ndikuar ndjeshëm cilësinë e jetës së pacientit dhe familjarëve. Objektivi i projektit ka të bëjë me rritjen e aksesit dhe cilësinë e shërbimit të kujdesit paliativ për pacientët me kancer dhe të sëmurët kronikë në Bashkinë Durrës; monitorimin dhe vlerësimin, në harkun e 12 muajve; Zbatimin e protokolleve dhe të ligjit për Kujdesin Paliativ në 14 qendra të kujdesit shëndetsor në bashkinë e Durrësit (zona urbane dhe rurale); Nxitjen e përfaqësuesve të institucioneve shëndetësore të shërbimit parësor (ISKSH; DSHP), atë të specializuar (klinika e specialiteteve), duke përfshirë dhe spitalin rajonal për sigurimin e shërbimit paliativ ashtu sic parashikohet nga ligji; Ndërgjegjësimin e punonjësve shëndetësor për të ofruar shërbim paliativ sipas protokolleve klinike dhe zbatimin e ligjit për kujdesin paliativ.	12	Durrës
11	Qendra për Studim & Trainim "ILLUMINATOS"	Diversiteti i Shërbimeve Sociale dhe Publike në disa NJA të Bashkisë së Tiranës në kontekstin e ndarjes së re administrative-territoriale.	Monitorimi dhe advokimi i zbatimit nga ana e Bashkisë së Tiranës të (1) Shërbimit social të Strehimit për familjet e pastreha me kryefamiljare gruan në NJA 1-11; dhe (2) Shërbimit publik të Ujitjes dhe Kullimit në NJA Pezë dhe NJA Ndroq; në respektim paketës ligjore për Strategjinë Ndër-sektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen vendore.. Përzgjedhja e këtyre dy shërbimeve në një Projekt-Propozim të vetëm është bërë me synimin e vetëm që të rrisë aksesin dhe cilësinë e shërbimit dhe të informojë grupet e interesit për ndryshimet ligjore që janë bërë nga kalimi i kompetencave të këtyre shërbimeve nga pushteti qendror në atë lokal, mbas zgjerimit të Bashkisë Tiranë.	11	Tiranë (Njësitë Administrative 1-11 dhe NJA Pezë, Ndroq)
12	Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile (CSDC)	Rinia e Kavajës, aktive në Qeverisjen Lokale	Përfshirja aktive, e informuar dhe vullnetare e qytetarëve në vendim- marrje është e një rëndësie të veçantë në ndërtimin e një shoqërie demokratike. Problematikat ekonomike, sociale, apatia, mosbesimi, mundësitë e pakta të edukimit dhe aftësimin për të drejtat dhe përgjegjësitë ka krijuar një nivel të ulët të pjesëmarrjes së të rinjve duke reflektuar në një demokraci të brishtë. Projekti ka si synim të krijojë një mjedis të sigurt për aftësimin e të rinjve në Bashkinë e Kavajës për adresimin e problematikave prioritare në komunitet e tyre dhe krijimin e një kulture aktive qytetare në proceset vendim-marrëse. Të mobilizojë dhe të rrisë kapacitetet e të rinjve për të adresuar prioritetet dhe nevojat e komunitetit në Bashkinë e Kavajës, nëpërmjet proceseve vendim-marrëse dhe ndërmarrjes së iniciativave dhe fushata konkrete.	10	Kavajë

PROJEKTET NË ZBATIM THIRRJA E 3-TË

GRANT-MARRËSIT ORGANIZATA JO FITIM-PRURËSE

Nr	Organizata	Projekti	Përshkrim i Shkurtër	Kohëzgjatja (muaj)	Zona e Zbatimit
13	Shoqata "RUNJA"	Monitorim i buxhetit , planeve , politikave, strategjive ne mbrotje te mjedisit me theks konkret pyjet e ulta dhe te larta, hartimi i planit te veprimit afatmesem dhe afategjate.	Në Bashkinë Dibër, popullata e ka lëndën drusore burimin kryesor të energjisë për ngrohje e gatim. E gjitha kjo lëndë drusore përthithet nga pyjet nga persona të pa licensuar . Janë me shumë se 25 vite shfrytëzimi pa kriter i pyjeve pa asnjë plan të mirfilltë menaxhimi, ku mjedisi ka pësuar një dëm kolosal dhe të pa rikuperueshëm në shumë zona. Kjo vihet re nga turrat e druve në çdo lagje e lulishte ,që u ngjajnë fushave të druve. Në Bashkinë Dibër, planifikimi në buxhet është në vlera të paperfillshme për mjedisin. Tarifimi nuk i përmbahet parimit kosto = tarifë. Edhe ato tarifa që mbliidhen nuk shkojnë për mjedisin. Mungesa e planeve, politikave , strategjive ose neglizhimi i tyre po bën që vit pas viti mjedisi të pësojë dëme të pa llogaritshme. Ky projekt synon një monitorim të plotë të të gjithë situatës së ndërhyrjeve nga Bashkia Dibër, buxhetin e harxhuar nga njësia vendore, planet dhe strategjitë që ekzistojnë dhe realizueshmëria apo konsiderata e drejtuesve për to.	10	Dibër
14	Qendra UET	Monitorimi i shërbimit te ofruar nga “Eco Tirana”, partneriteti publik privat italo shqiptar per realizimin e pastrimit te kryeqytetit.	Shërbimi i pastrimit të qytetit të Tiranës përbën një nga elementët më të rëndësishëm në detyrimet që Bashkia e Tiranës ka ndaj qytetarëve të saj dhe qytetit. Monitorimi gjatë fazave të zbatimit të Kontratës Eco Tirana do të fokusohet në plotësimin e standardeve dhe detyrimeve, që do të shoqërohet me analiza dhe me vlerësime reale. Për këtë, në mënyrë që të evidentojmë mënyrën e ofrimit të këtij shërbimi në partneritet publik-privat, projekti do të monitorojë zonat ku sipas kontratës kompania fillon punën për vitin e parë, zonë e cila njihet në kontratë si “zona e kuqe” e Tiranës.	10	Tiranë
15	European Youth Association	Monitorim i granteve e biznesit social rinor	Në kuadër të promovimit dhe nxitjes së klimës së biznesit në nivel vendor, Bashkia Tiranë ka shpallur mbështetjen me grante individuale të biznesit social rinor në kuadër të projektit për Fondin e Programit të Nxitjes së Punësimit. Buxheti ne dispozicion te 40 granteve do te jete 20.000.000 leke te reja, ku 50% do të jene grante per biznese sociale dhe 50% për orientimin e te rinjve drejt një profesioni. Ndërhyrja synon monitorimin e procesit të grantimit nëpërmjet raportimit me fisha dhe mbikëqyrja fizike dhe online e procesit dhe mjeteve ligjore në dispozicion, monitorimin e zbatimit të granteve dhe ecurinë e tyre ekonomike dhe sociale si dhe advokim të vazhdueshëm në funksion të promovimit dhe përmirësimit të këtij procesi dhe angazhimit të aktorëve publik që ndikojnë në këtë vendimmarrje si Bordi Rinor i Tiranës, Këshilli Bashkiak, mediat dhe organizatat rinore që operojnë në kryeqytet.	7	Tiranë

PROJEKTET NË ZBATIM THIRRJA E 3-TË

GRANT-MARRËSIT ORGANIZATA JO FITIM-PRURËSE

Nr	Organizata	Projekti	Përshkrim i Shkurtër	Kohëzgjatja (muaj)	Zona e Zbatimit
16	Shoqata Visare	Platforme Multimediale per nje Kavaje te paster	Monitorimi i Bashkisë Kavajë për zbatimin e ligjit mbi administrimin e mbetjeve urbane në lagjet e qytetit. Krijimi i një modeli të ri bashkëpunimi qytetar-aktivistë-pushtet vendor, bazuar në ligj. Adresimi i problematikave dhe paraqitja e modeleve të pastrimit të territorit përmes medias. Advokim në nivel vendor deri tek hallka fundore e Organizatës Jofitimprurëse ndërlidhëse, komunikimi qytetar-institucion me qëllim monitorimin dhe realizimin e pastrimit të qytetit.	12	Kavajë
17	REFLEKSIONE	Monitorim i Mekanizmit të Referimit të rasteve të dhunës në familje në nivel lokal - aktivizëm qytetar për përmirësimin e tij.	Ka rritje të dhunës në familje të shfaqur me raste konkrete, mjaft shqetësuese për gjithë shoqërinë, sidomos në bashkitë Fier dhe Lushnjë. Projekti synon angazhimin e qytetarëve në përmirësimin e Mekanizmit të Referimit (MR) për adresimin e rasteve të dhunës në familje dhe parandalimin e tyre. Objektivat specifike kanë të bëjnë me a) monitorimin e MR në Bashkitë Fier & Lushnjë & Korçë përmes ngritjes dhe funksionimit të instrumentit novator "Plani Operacional i Monitorimit" dhe promovim i modelit pozitiv të Korçës; b) angazhimin e 120 qytetarëve nga komunitetet e qytetarëve në 3 bashkitë për të përmirësuar MR përmes pjesëmarrjes së tyre në advokim/lobim; c) krijimit të aleancës me mediat lokale për nxitjen e angazhimit qytetar dhe përfaqje pozitive gjinore në mbulimin mediatik të rasteve të dhunës në familje.	12	Fier, Lushnjë, Korçë
18	Qendra AGENDA	Pjesëmarrje aktive e qytetarëve në hartimin e buxhetit në bashkitë e Durrësit, Elbasanit dhe Korçës.	Qeveria lokale në pamundësi për të dëgjuar zërin e çdo qytetari të thjeshtë apo të çdo grupi interesash të caktuar harton një buxhet që nuk përfaqëson secilin prej tyre në formën e masën më të mirë të mundshme. Në këtë kontekst, projekti synon që buxheti me pjesëmarrje të mos jetë më në formën e tij klasike, por duke ofruar një mënyrë më bashkëkohore të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe një instrument më efikas që rrit mundësinë e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e buxhetimit. Kjo mënyrë vjen në formën e një aplikacioni të posaçëm, ku çdo qytetar të ketë mundësinë të japë inputin e vet për mënyrën sesi duhet përdorur buxheti vjetor i bashkive. Qëllimi kryesor është rritja e pjesëmarrjes dhe ndikimit të qytetarëve në hartimin e buxhetit të bashkive. Objektivat e projektit janë: - Rritje e aksesit të qytetarëve në hartimin e buxhetit;- Rritje e pjesëmarrjes së qytetarëve (sidomos të rinjve) në vendimmarrjen vendore; - Rritje e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e zyrtarëve.	12	Durrës, Elbasan, Korçë

PROJEKTET NË ZBATIM THIRRJA E 3-TË

GRANT-MARRËSIT ORGANIZATA JO FITIM-PRURËSE

Nr	Organizata	Projekti	Përshkrim i Shkurtër	Kohëzgjatja (muaj)	Zona e Zbatimit
19	Qendra për Transparencë dhe Informim të Lirë	Lufta kundër korrupsionit në pushtetin lokal përmes zbatimit të rekomandimeve të KLSH nga bashkitë	Nga monitorimet e mëhershme të organizatës (2015) është gjetur se vetëm 38.5 për qind e rekomandimeve të KLSH zbatohen nga institucionet publike. Janë përzgjedhur 5 bashki ose 20% nga bashkitë e audituara nga KLSH gjatë 2016, duke pasur parasysh një kampion përfaqësues për të gjitha llojet e bashkive, të mëdha, të mesme dhe të vogla. Projekti synon rritjen e përgjegjshmërisë së bashkive dhe institucioneve të varësisë për zbatimin e ligjit, forcimin e luftës kundër korrupsionit dhe rritjen e transparencës. Objektiva specifike kanë të bëjnë me a) monitorimin e 150 rekomandimeve në 5 bashki për të rritur nivelin e zbatimit të tyre përmes identifikimit të problematikave që lidhen me moszbatueshmërinë e rekomandimeve; b) ndërgjegjësimin e qytetarëve rreth nevojës së zbatimit të rekomandimeve të KLSH përmes publikimit të gjetjeve në median kombëtare apo lokale dhe rrjetet sociale.	10	Lushnjë, Maliq, Elbasan, Prrenjas, Pogradec
20	Qendra e Studimeve dhe Zhvillimeve (QSZH)	Për një shërbim cilësor social për fëmijët, të rinjtë dhe emigrantët e rikthyer	Bashkia Maliq dhe Prrenjas kanë në prioritetet e tyre përfshirjen sociale të grupeve në nevojë, të rinjtë, të rikthyerit nga emigrimi në bazë të ligjit Nr.139/215 "Për Vetqeverisjen Vendore, neni 24. Të kthyerit nga emigrimi vuajnë pasojat sociale të ri-integrimit dhe të përfshirjes në shoqëri. Projekti synon përmirësimin e kushteve ekonomike shoqërore të të rinjve, për lehtësimin dhe ri-integrimin e të rikthyerve në shoqëri. Objektivat specifike të projektit kanë të bëjnë me a) krijimin e paketës së shërbimeve sociale ad-hoc dhe lobimin për miratimin e saj nga bashkitë; b) përfshirjen e komunitetit në përmirësimin e aksesit të tyre në shërbime sociale cilësore.	8	Maliq, Prrenjas
21	Qendra "Lëvizja MJAF!"	Promovimi i vlerave demokratike dhe medias aktive mes të rinjve	Në bashkitë e përzgjedhura politikat produktive për të rinjtë përgjithësisht kanë munguar apo nuk kanë dhënë rezultate të prekshme. Ndërkohë jeta rinore në këto bashki është e vakët. Projekti synon të fuqizojë të rinjtë për t'u përfaqësuar dhe për të ndikuar në vendimmarrjen lokale për përmbushjen e prioritetëve të tyre. Objektivat specifike kanë të bëjnë me a) rritjen e kapaciteteve profesionale për 60 të rinj për të reaguar publikisht mbi shqetësimet dhe prioritetet e tyre b) zhvillimin e monitorimit në nivel lokal të zbatimit të politikave dhe mundësive për rininë dhe rritje e presionit ndaj institucioneve vendore për llogaridhënie, përmes kërkesave për informim publik të drejtuara pushtetit vendor.	12	Shkodër, Elbasan, Korçë, Vlorë

PROJEKTET NË ZBATIM THIRRJA E 3-TË

GRANT-MARRËSIT ORGANIZATA JO FITIM-PRURËSE

Nr	Organizata	Projekti	Përshkrim i Shkurtër	Kohëzgjatja (muaj)	Zona e Zbatimit
22	Linja e Këshillimit për Grat dhe Vajza	Shërbimi social dhe shëndetsor për grupet e marginalizuara	Shërbimet për grupet vulnerabël në Shqipëri kanë problematika të ndryshme dhe calojnë në cilësi, në shtrirje, në gamën e kufizuar, etj. Për të kuptuar më qartë se në ç' masë dhe si ofrohen shërbimet, duke marrë në konsideratë nevojën për shërbime më të mira, numrin në rritje të përfituesve dhe ndryshimet e mëdha demografike, lind nevoja të monitorohet zbatimi i standardeve egzistuese në ofrimin e shërbimeve sociale, të miratuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.505, datë 13.7.2011, dhe Udhëzimin Nr. 13, datë 17.12.2012. Projekti synon të kontribuojë në zbatimin e cilësisë së shërbimeve sociale dhe shëndetsore në qendrat e përkujdesjes shoqërore, për viktimat e dhunës, të moshuarit dhe familjet në qendrat rezidenciale. Objektivat specifik kanë të bëjnë me: a) njohjen e cilësisë dhe masës të zbatimit të VKM nr.505, datë 13.7.2011, dhe Udhëzimin Nr. 13, datë 17.12.2012, për viktimat e dhunës në familje; b) përmirësimin e transparencës institucionale nëpërmjet ndërgjegjësimit dhe advokimit lidhur me shërbimet e përkujdesjes sociale dhe shëndetësore; c) njohjen nëpërmjet monitorimit të zbatimit në praktikë të detyrimeve ligjore të punonjësve të shëndetësisë legjisacionit lidhur me dhunën në familje.	12	Elbasan, Cërrik, Gramsh, Roskovec, Tiranë
23	CESA	Përmirësimi i cilësisë së higjenës në tregun e hapur për Bashkinë e Durrësit	Në territorin e Bashkisë Durrës funksionon vetëm një treg publik për shitjen e produkteve agro ushqimore dhe rikonstruksioni i tij të fundit daton në vitin 2002. Qëllimi i projektit është përmirësimi i kushteve në infrastrukturën e tregut të hapur agro ushqimor Durrës dhe përmbushja e kërkesave ligjore të përcaktuara në legjisacionin në fuqi. Objektivat specifike kanë të bëjnë me a) monitorimin e mënyrës së ushtrimit të funksioneve publike të Bashkisë Durrës në lidhje me mirëmbajtjen e tregut të hapur ushqimor në qytetin e Durrësit. b)advokimin pranë Bashkisë Durrës dhe Këshillit Bashkiak për të marrë masave urgjente për përmirësimin e situatës aktuale.	8	Durrës

PROJEKTET NË ZBATIM THIRRJA E 3-TË

GRANT-MARRËSIT ORGANIZATA JO FITIM-PRURËSE

Nr	Organizata	Projekti	Përshkrim i Shkurtër	Kohëzgjatja (muaj)	Zona e Zbatimit
24	Fondacioni Rruga me Pisha	Qeverisja Vendore përballë nevojës së zhvillimeve kulturore	Edhe pse zona e Vlorës, Himarës dhe Sarandës kanë potencial turizmin, në këto bashki konstatohet që kanë mungesa të planeve strategjike në zhvillimin kulturor dhe turizmin kulturor, si pjesë e përgjithshme të planeve strategjike të zhvillimit të NJQV – ve. Qëllimi kryesor i projektit është përfshirja e qytetarëve në hartimin dhe planifikimin strategjik vendor mbi artin, kulturën dhe turizmin kulturor. Objektivat specifike kanë të bëjnë me: a) advokimin nëpërmjet përfshirjes së qytetarëve dhe grupeve të interesit në planifikimin strategjik afatgjatë në këta sektore në këto NJQV, dhe garantimi i qëndrueshmërisë së kësaj përfshirjeje me qëllim rritjen e punësimit dhe të të ardhurave për sektorin e pavarur kulturor në mënyrë të qëndrueshme. b) garantimi i pjesëmarrjes së qytetarëve “skenës së pavarur kulturore vendase dhe grupeve të interesit të NJQV -ve Sarandë, Vlorë dhe Himarë” në proceset e buxhetimit të artit, kulturës dhe turizmit kulturor në këto njësi.	12	Vlorë, Himarë, Sarandë

PROJEKTET NË ZBATIM THIRRJA E 3-TË

GRANT-MARRËSIT INDIVIDË

Nr	Organizata	Projekti	Përshkrim i Shkurtër	Kohëzgjatja (muaj)	Zona e Zbatimit
1	Arjana Bardhaj	GURORET: Lobimi, Advokimi nëpërmjet krijimit të grupeve ekologjike	Ndotja e ambientit është edhe një nga faktorët negativ të shkaktuara nga guroret në bashkinë e Urës Vajgurore. Ky projekt synon përmirësimin e mjedisit, cilësinë e jetës së qytetareve dhe shfrytëzimin me kriter të pasurive natyrore. Objektivat specifike kanë të bëjnë me: a) rritjen e transparencës ndaj komunitetit për kontratat e lidhura me kompanitë e shfrytëzimit të guroreve dhe rritje e përgjegjshmërisë sociale të këtyre kompanive; b) ndërgjegjësimi dhe angazhim i rritur i komunitetit të qytetarëve të Urës Vajgurore dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit nga ndotjet e ajrit dhe të jetesës e ambientit të bashkisë së tyre nga aktiviteti që ushtrojnë 9 guroret dhe 5 furrat e gëlqeres.	12	Ura Vajgurore
2	Sokol Kosta	Gjanica, lumi i vdekur	Lumi Gjanicë është një nga lumenjtë më të ndotur në Shqipëri për shkak të depozitimit të mbetjeve të industrisë së naftës. Projekti synon rritjen e ndërgjegjshmërisë dhe aktivizimit të rinjve në monitorimin e ndotjes së lumit Gjanicë nëpërmjet përdorimit të teknologjisë. Objektivat specifike kanë të bëjnë me : a) zhvillimin e një aplikacioni për Android që të përdoret nga të rinj dhe vullnetarë për të bërë të mundur identifikimin e problemeve mjedisore të lumit Gjanica; b) publikimin e rezultateve monitoruese përditësuese nga përdorimi i aplikacionit në një faqe të aksesueshme për qytetarët, c) ndërgjegjësimin e organeve vendimmarrëse për të monitoruar dhe vepruar sipas ligjeve në fuqi kundrejt shkaktareve të këtij problemi.	12	Mallakastër, Fier, dhe Patos.
3	Migena Nako	Përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve publike në zonën e ish-Kënetës përmes hulumtimit pjesëmarrës dhe vizual	Zona e ish-Kënetës ka probleme shumë të mëdha me infrastrukturën. Ky projekt synon përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve publike në zonën e ish-Kënetës përmes përdorimit të teknikave hulumtuese pjesëmarrëse dhe vizuale. Objektivat specifike kanë të bëjnë me a) dokumentimit nëpërmjet hulumtimit të problemeve me shërbimet publike dhe infrastrukturën në 11 mini-lagjet që shtrihen në zonën e ish-Kënetës. b) ushtrimin e presionit ndaj përfaqësuesve vendorë përmes teknikave të hulumtimit pjesëmarrës dhe vizual për përmirësimin e shërbimeve publike dhe infrastrukturës.	10	Durrës (ish-Kënetë)

PROJEKTET NË ZBATIM THIRRJA E 3-TË

GRANT-MARRËSIT INDIVIDË

Nr	Organizata	Projekti	Përshkrim i Shkurtër	Kohëzgjatja (muaj)	Zona e Zbatimit
4	Endrit Shabani	Amicus - Arti politik përmes medias vizive online	Shqipëria konsiderohet si vend me liri të kufizuar të medias dhe media televizive nuk e monitoron në mënyrë të paanshme punën e bashkësive. Por edhe në ato raste kur ka denoncime për abuzim me pushtetin, kjo mbetet në raportime sporadike pa arritur të ofrohen analiza të thelluara socialpolitike për të shpjeguar fenomenin, dhe hapat që duhen ndërmarrë për zgjidhjen e tij. Ky projekt synon nga njëra anë t'i tregojë të rinjve përse disa gjëra nuk funksionojnë mirë në administrimin e qytetit dhe kush janë përgjegjësitë autoriteteve vendore, si dhe të nxisë përgjegjshmerinë e zyrtarëve vendore dhe llogaridhënien e tyre përballë të rinjve të qytetit. Qëllimi i këtij projekti është të nxisë përgjegjshmerinë e zyrtarëve vendore dhe llogaridhënien e tyre përballë të rinjve të qytetit. Objektivat e projektit janë: a) informimi dhe edukimi i të rinjve përmes dhjetë filmave me metrazh të shkurtër për problematikat e qytetit dhe rolin e tyre në shoqëri; b) rritja e presionit publik ndaj bashkësive përmes nxitjes së aksioneve qytetare	12	Tiranë, Durrës, Elbasan, Lezhë, Pogradec (në nivel qyteti)
5	Brejdon Xhavora	Ndërgjegjesimi dhe Mobilizimi i Komunitetit Rom dhe Egjiptian për Subvencionimin e Qirasë	Përgjatë Bregut të Lumit, në zonën e Siri Kodrës jetojnë rreth 40 familje të komunitetit rom dhe egjiptian për më shumë se 15 vjet dhe një numër i konsiderueshëm i tyre jetojnë në barraka. Qëllimi i këtij projekti është mbështetja e veprimeve advokuese të grupit të aktivistëve dhe anëtarëve të komunitetit rom dhe egjiptian në zonën e Siris Kodres, Tiranë në funksion të përmirësimit të situatës së strehimit. Objektivat kryesore janë: kategorizimi i familjeve dhe individëve sipas profilit socio-ekonomik; nxitja e zbatimit efektiv të bonusit të strehimit në dobi të familjeve romë dhe egjiptiane që jetojnë në zonën e Siri Kodres; dokumentimi i pengesave gjatë zbatimit të programeve të strehimit dhe paraqitja e rekomandimeve për përmirësimin e tyre	8	Tiranë
6	Ina Hoxha	JuFlet Rinia	Bashkia Korçë prej vitësh ka lançuar kartën 16/24, që ofron lehtësira për të rinjtë e kësaj bashkie, por ende kjo kartë nuk është funksionale. Qëllimi i këtij projekti është vënia në zbatim të kartës rinore 16/24 përmes angazhimit të të rinjve dhe adresimit të kësaj problematike pranë pushtetit lokal. Objektivat kryesorë të projektit janë: advokimi në pushtetin lokal për miratimin e kartës rinore dhe funksionalitetin e saj; informimi i të rinjve përmes takimeve dhe videove për çështjen e kartës rinore në mënyrë që të behen pjesë e kësaj kauze për adresimin e saj pranë pushtetit lokal.	8	Korçë

PROJEKTET NË ZBATIM THIRRJA E 3-TË

GRANT-MARRËSIT INDIVIDË

Nr	Organizata	Projekti	Përshkrim i Shkurtër	Kohëzgjatja (muaj)	Zona e Zbatimit
7	Nolian Lole	Dua të bëhem polic se ai është miku ynë...	Edukimi i fëmijëve në lidhje me çështjet e sigurisë nëpërmjet mësuesve dhe punonjësve të policisë sjell përfitime edukative dhe ndryshon mentalitetin e prindërve që i keq-mësojnë fëmijët në raport me figurën e punonjësit të policisë. Qellimi i projektit është përmirësimi i policimit në komunitet në Tiranë duke rritur bashkëpunimin ndërmjet fëmijëve dhe policisë. Objektivi i projektit është edukimi i fëmijëve në 20 shkolla mbi rolin e policisë së shtetit në komunitet si dhe forcimi i bashkëpunimit ndërmjet fëmijëve dhe policisë së shtetit.	8	Tiranë
8	Ariana Cela	Trashëgimia kulturore si pjesë integrale e planeve zhvillimore në Bashkinë e Korçës: Muzetë Lëvizës	Një qasje e re kërkohet të përshtatet ku Bashkia e Korçës jo vetëm të rrisë financimet apo bashkëfinancimet vendore në programin e kulturës, por edhe të ridimensionojë qëndrimet ndaj objekteve të trashëgimisë kulturore. Projekti synon monitorimin e situatës së buxhetimit të programit të kulturës dhe advokimin me grupet e interesit për rritjen e financimeve në këtë program në buxhetin 2018; ndërtimin e audiencave përmes qasjes së muzeut interaktiv në dy muze të përzgjedhura; ndërgjegjësimi i banorëve, komunitetit të biznesit apo grupime të rinjsh mbi impaktin e trashëgimisë kulturore.	10	Korçë
9	Arlind Lugji	Prona publike për të mirën publike	Ky projekt propozim adreson çështjen e strehimit të 40 familjeve të komunitetit romë dhe egjiptian të zonës së Selitës në Tiranë. Projekti synon që përmes angazhimit të familjeve të prekura nga ndërtimi i unazës, ekspertizës teknike dhe përfshirjes së institucioneve ndërkombëtare, të nxitet Bashkia e Tiranës për të dalë me një zgjidhje të qëndrueshme për strehimin afatgjatë të familjeve. Projekti synon adresimin e çështjes së strehimit të këtyre familjeve të pastreha si dhe me gjere, përmes menaxhimit dhe përdorimit me efektiv të pronës shtetërore vendore në administrim të Bashkisë Tiranë.	6	Tiranë